

Mehmet Bislimi

TRËNDAFILA MAJI

Poezi

(ribotim me ndryshime)

Shoqata kulturore Shqiptare
„Mëmëdheu“ St. Galen – Zvicër 2002

Redaktor: Bedri Halimi

Lektor: Kadri REXHA

Desing & Layout
Adnan ASLLANI

Copyright & autori

Mehmet Bislimi

TRËNDAFILA MAJI

Ç’kuptim ka ferri i Datës
Këngëtuar shekuj më parë
Në krahasim me ferrin e Dubravës –
Që Serbia e hapi për shqiptarë...

Me ndjenjën e thellë të respektit për të rënë
Në majin e vitit '99 në burgun e Dubravës.
- Autori

Parathënie

Shumë njerëz, të devotshëm për vendin e tyre dhe të përkushtuar ndaj tij, në vitet e gjata të qëndresës e më pas të luftës kundër pushtuesit serb, i lanë disi mënjane ndonjë nga prirjet e tyre artistike apo letrare, duke vënë gjithçka në shërbim të lirisë. Ata, për një çast, dëshiruan më mirë të ishin luftëtarë të denjë, publicistë, agjikator, njerëz të organizimit të veprimtarisë çlirimtare dhe këtë nuk e bënë rastësisht, por me qëllimin e lartë, se tashmë fjalën e kishte diçka tjetër më e madhe. Më pas, pas qershorit të vitit 1999, ata rifilluan ciklin ndaj „pengut“ të hershëm të tyre – poezisë apo prozës. Njëri prej tyre është edhe ish i burgosuri politik dhe veprimtari i madh i çështjes kombëtare, Mehmet Bislimi, i cili del tashmë para lexuesit me vëllimin e tij të dytë, botuar brenda pak kohësh, respektivisht me vëllimin e parë të tij me poezi.

Mehmet Bislimi e njoh prej shumë vitesh dhe e kam ditur gjithnjë se ai ka një shpirt lirik, i ndjeshëm dhe i kujdesshëm ndaj shokëve, por kurrë nuk e kisha menduar se ai ishte poet, dhe duhet thënë, poet i fuqishëm, në të cilin vargu tradicional ndërthuret me poezinë moderne shumë natyrshëm, ku lirika dhe epika qëndrojnë së bashku krejt natyrshëm.

Nuk e kisha menduar se Mehmet Bislimi ishte poet kaq i mirë, kaq i drejtpërdrejtë dhe njëkohësisht kaq lirik. Njerëzit që kanë qenë të përfshirë furishëm dhe fuqishëm në luftë, që më shumë se dy dekada iu kanë përkushtuar me shpirt veprimtarisë për lirinë e Kosovës, në dukjen e parë e kanë të vështirë të jenë lirik, sepse kanë pasur një jetë të vështirë, gjithë përplasje, jetë të kaluar mes burgjeve, ndjekjeve, dhe torturës nga policia serbe.

Në këto rrethana është e vështirë të mbetesh lirik i fjalës. Por Mehmet Bislimi e ka ruajtur lirizmin e tij, e ka ruajtur dhe kultivuar shumë vite brenda vetes, si një tufë trëndafilash, për ta shfaqur tani, pas luftës, në mesin e lexuesve dhe jam i bindur se do të mirëpritet.

Që të jem i saktë, kur e kam njohur Mehmet Bislimin, ka qenë kohë e vështirë, por edhe e bukur. Luftohej për sendërtimin e idealeve të mëdha, dhe ai ishte njëri nga djemtë e Kosovës, në organet drejtuese të organizatës ilegale çlirimtare në Perëndim, por që shumë punë i bënte legalisht, sepse haptas fliste me njerëzit, haptas u kërkonte atyre të ndihmonin luftën çlirimtare, ashtu si më vonë, duke bërë pjesë në grupin për marrëdhëniet me jashtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, haptas do të fliste edhe me përfaqësues të mendimit politik ndërkombëtar. Shpesh herë ishte i rreptë, i ashpër nganjëherë, në ndonjë rast disi i lodhur, por kurrë nuk e kishte humbur optimizmin e tij për një të ardhme më të bukur.

Si duket për këtë (ndonëse nuk e kishim ditur), atë e kishte ndihmuar edhe poezia që flinte brenda tij dhe që priste lirinë të dilte. Mehmet Bislimi, militanti i ditëve të lirisë së Kosovës dhe poeti i tashëm e plotësojnë njëri tjetrin krejt natyrshëm, janë vazhdim i njeri tjetrit. Jo për faktin se janë i njëjti njeri, por poeti nuk e ka tjetërsuar luftëtarin, dhe nga ana tjetër poezia nuk e ka bërë atë të largohet nga vitet e luftës. Përse e them këtë? Jo thjeshtë se edhe në vargjet e tij, megjithëse lirik. Ai mbetet militant dhe luftarak, por edhe se shumica e poezive të tij u janë kushtuar shokëve të tij luftëtarë, që ranë në fushën e nderit. Vargjet më të arritura, herë pas herë, ai i ka pikërisht për të rënë e pavdekshëm, të cilët i ka njohur nga afër, ka bashkëpunuar ma ta, megjithëse nuk e thotë këtë modestisht, dhe për të cilët ai ndjen respekt gjithnjë në rritje.

Një vëllim me poezi në jetën artistike të një vendi zakonisht është një gjë e zakonshme, sepse përditë botohen libra. Por botimi i këtij libri nuk është i tillë. Është më tepër se kaq. Është homazh për luftën dhe për idealet e saj, nderim për të rënë dhe për përkushtimin e tyre, dëshmi e një shpirti lirik dhe e vargjeve që të mbeten në mendje, dhe njëkohësisht një shteg i çelur tejet bukur për vëllimet e tjera poetike. Në fund të fundit ky është një vëllim që do të mbetet dhe do të ndodhë kjo sepse janë në të përmasat artistike dhe lirike, shpirti i hollë poetik i një luftëtar dhe militantizmi i një poeti, të gjitha të ndërthura me njëra tjetrën. Ky do të jetë një vëllim jo vetëm për ata që bënë luftën, por edhe për të tjerët, sepse është një dëshmi artistike e një poeti.

Nuk e kam marrë përsipër të bëj analizën e vargjeve. Një gjë e tillë mund të behët më vonë nga vet lexuesit ose kritikët. Unë vetëm desha të dëshmoj se ju keni në duar vargjet e spikatura të një njeriu poet dhe të një poeti luftëtarë, andaj do e keni të vështirë të mos riktheheni përsëri në rileximin e tij.

Bedri ISLAMI – Publicist

THEMELET E GURTA

Kujdes

Gdhendje
Njeriut të gurëzuar
Nga jeta sprovuar
Në vaj e uthull rrahur
Bukën lyer me turp
Mos e hani
Ju
Miq të vonuar

Nga gërryerjet e kohës
Shpirti lënduar
Pakujdesitë që kushtuan
Miq të vonuar
Kujdes
Mbi të vërtetën
Mos gërryeni
Hiqni dorë nga ky ves

Mbi muret e Dubravës

Muret e Dubravës me tela
Ferrin e Dantes e vunë në lojë
Lugetërit serb të mesjetës
Me thikën e urrejtjes në gojë
Në mes
Këputën rrugën e jetës

...172 të dënuar shqiptarë
Fat lidhur në zinxhirë
I vranë

Ferri i Dantes
Mbi ferrin e ri të Dubravës
Kuptimin humbi
Skenar i vjetër i Serbisë
Mbi shqiptarët

Rivënë në lojë

Spektatorë ndërkombëtarë
Sehir mos bëni
Me gjakun e derdhur plojë

Kullat

Mure të gurta
Mure të trasha
Mbijetesën sinonim
Kohë në gërshetim
Frëngji të vogla
Si syri i liqenit
Nga ku shënohet bota
Lakmitare në marshim

Në mbrojtje të qenies
Të shpirtit
Të kulturës
Të dinjitetit
Popull në mbijetesë
Për mes kullës
E frëngjisë sy zezë

Kullat në gji
Nga një copë histori kanë
Kullat Legjendën
Bënë

KËGË NOSTALGJIE

Atdheut tim

Më zuri kënga në faj
Këngë a vajë

Me gurë po bisedoi
Gurët në gjoks rëndojnë
Larg vatrës
Alban biri im
Prehje s'ka
Larg tokës sate hallemadhe
Në përmallim

Këngë a vajë
Kënga më zuri në faj
Atdhe

Zjarri i vatrës sime

Gjurmë e lashtë historie
Të guri i oxhakut

Në tokën e plakut
Shkruar me thëngjij
Testamenti im i djegur

Pullazi i vjetër i çatisë
Ujë e lot pikon
Ditë shprese a stacion harrimi
Për ata që i mungojnë shqiptarisë
Nga strehë e çatisë
Pikon
Lot e gjak
Pikon

Djepi

Në gjirin e tij
Ninullat e tokës sime
Peshojnë e rëndojnë
O kohë e butë në ikje
Se bashku me ninullat
Ruani kujtimet
Për trimat

Me ndjenjën e atdheut në gji
Trimat përkundi
Djep i legjendës
Këngët e lirisë
Porosinë e nënës
S'e harruan

Mos

Me flakën e zjarrit që djeg
Kanë lozur
Mbretër e sundimtarë
Gjithë ajo lojë e marrë me zjarr
Derdhur pamëshirshëm
Si nga gojë e kuçedrës
Në përrallë
Derdhur mbi njerëzinë
As atëherë
As sot
Nuk ishte krejt përrallë

Mos

Mos digjni me zjarr

Dëshirën për liri

Mosni

Mosni

Një ditë

(Dëshira ime)

Një ditë befas do të vijë
Pa letra viza e pasaporta
Tek ti o nënë Shqipëri
Përmes malesh
Jo nga porta...

Erdha të pashë
Ëndërr kamotshme imja
U realizua
Të kam dashur pa hile
Atdhe i ndarë hilesisht në mes
Edhe më shumë të dua

Shqipëri
Ka vetëm një
As njëherë dy

Natë

Ku veprojnë njerëzit
E territ
Si nata
Iyer me të zi ata

Natë shqiptare
Nën pranga shekullore
Natë ferri
Natë ku shqiptari n'torturë
Qëndroi e nuk u lig

Natë vigajsh e ngadhënjimi
Natë e fundit para agimi
Kosovë
Mbase terrin shqeve

BALADË PËR SHOKËT

Unë dhe ti

(A. Zhitisë)

Dikur
Një ajër thithnim të dy
Dikush qëlloi mbi ne
Afrim
Qëlloi mbi ty

Dikush gjatë tërë jetës
Turpin me bukë duhet ngrënë

Ti sinonim i qëndresës
Testamentin lënë
Liri para jetës

Po vjen pranvera

Lulëkuqet e pranverës
Lidhur kujtim
Pa ju
S'do kishin kuptim

Pranverat do vijnë e shkojnë
Pa emrin tuaj
Zogjtë e lirisë në pranverë
Nuk fluturojnë

Dëshmorët
Luleve ngjyrë iu dhanë
Lulet e Pranverës në Kosovë
Ngjyrë gjaku kanë

Kthehu

Kur ktheheshin ne atdhe
Burrat
Nga burgu internimi
Nga rrugë e mërgimit
Burrat

Ti nuk e di peshën e kthimit
Kot po shkruaj

Ti nuk ke vlarë qetësinë
Pranë oxhakut
Me blozën e jetës nxirë
Me blozën e robit je pajtuar
Ndarje as kthim s'ke provuar
Prandaj kot po shkruaj
Me ndjenjën time ngrysur
Po grindem kot

Iku ajo kohë
Ti kthehu në heshtje
Hije e zezë
Pa zhurmë
Kthehu sot

Ukshin Hotit

Me përmasa njeriu
Me peshën e dheut

Gjithë ç'pati
Atdheut ia fali

Këngë e pa kënduar të mbanë në gji
Emri yt baraspeshë
Me emrin liri
Në bronz nuk të derdhen dot
U bëre përjetësi

Një jetë e tërë (J. Salihut)

Një jetë në shtegtim
Për bërje të lirisë
Të vetmin qëllim

Vdekjen në tallje e vuri
Mandati i vdekjes
Në pusi të ligësisë ra
Vdekje që u korit

Bacë Rifati

Më shumë ke e ka rënduar jeta
Ma gjeni
Më pak kë e ka luhatur goditja
Ma gjeni
Sakrificën më sublime kush bëri
Ma gjeni
Kush këndoi më mirë këngët e lirisë
Ma gjeni

Mustaqet krah me krah
Në përvjetorët e lavdisë
Bacë Rifati
Ulur këmbëkryq në kullën e zjarrit
Mirë se të gjejmë
Rrënja e shqiptarit

GJETHET E VERDHA

Plaku

Dikur e sot
Ulur pranë oxhakut
Hiye lehtë
Fjalë pak
Mendje hollë
Qelibarin në dorë mbante
Pushkës respekt i bënte
Plaku

Pranë oxhakut
Mos u ulni-
Nuk është vendi juaj
Të zot e vendit nuk jeni
Është vendi i plakut

Këpucës

Nuk të shohë dot grykës
Fytyrë nxirë
Futesh kudo si këpucë e ndyrë

I thërrisnim
Fytyrë opingë dikur
Tani në kohërat moderne
Fytyrë këpucë i thërrasim
Sa mirë
Opinga shpëtoj nga sharjet e grykësitë

A ka më keq

Filozofi e dyshimit ngatërruar
Në udhëkryqet e hamendjes
Mozaikun e lashtë
Në jetën e pengut ngatërron
Rrugë që s'e kupton

Foshnjat e sapo lindura
Që heshtin
Burra që qajnë
Më kërthizën për këmbë
Prerje në vend të gabuar
Kërthizë e infektuar
Ka edhe më keq sigurisht
Filozofi tërkuzë
Sakrificë që pa njerëzisht u përbuzë
Si ta pagëzojmë sublimen
Më tregoni

Bretkosat

Në bërakën tonë
Shëmtitë fill zunë
Këngën e bretkosave më të bilbilit
Ngatërruan
Dom Mjeda na ndjej
Bora po e s'po shkrihet

Eufori e bretkosave në pranverë

Ardhur nga një pus pa fund
Me dhëlpërinë e tyre nën gunë
Himnin desh përdhunuan

Dikur

Kur vinin ata
Rojat viheshin të kullat
Nga mali
Kanë zbritur
Burrat

Dikur
Vdisnin për atdhe
Burrat

Sot
Atdheun vdesin
Burrat
Dallimin gjejeni

Dy mendësinë

Derë e dritare hapur
Për t'u futur e për të ikur
Dy mendësi e pa shëruar
Nuk të kyça dot
Njeri në hamendje
Vargu yt i rëndë përgjysmë lënë

Ku do ishte ai
Sikur të mos ishte ti
Vrazhdësi e pa qëlluar
Derë hapur a mbyllur
Dy mendësi që mbaroi
Me harrimin tënd

Ngjyrë e verdhë

Çdo mbrëmje pranë tryezës së vogël
Me duart e veta të mplakura
Të zverdhura
Të ligjtë godet
Ardhmërinë përmes ngjyrës së verdhë
Ai nuk e sheh
Ai zgjidhjen kërkon
Vepron çdo ditë e nga pak
Të zverdhurit godet

E BARDHA QË VRET

Loti

Me lot kanë qarë shumë herë
Edhe të mëdhenjtë si fëmija
Lotët e vuajtjes që djegin

Botë e ligë
Të qofshim falur
Falë i qofshim zotit
A peshohen lotët e robit

Qëllimi

Nëse qëllimet i kemi
Të përbashkëta me dëshirat
Atëherë veprojmë
Atdheun po ashtu
Të përbashkët e kemi
Qëllimin arrijmë
Shpejtojmë

E pra më thuaj
I kemi të përbashkëta qëllimet

Dimri

Borë e bardhë si petkat e lara
Varur mbi pemë
Bardhësi që gënjen
Ndjenjat e marra të bulimit n'gem
Në kohën e pa kohë
Të varfëritë në shtrëngim
Kasolle e mjerë
S'nxjerr flakë as tym

Shpresë mikluese fikur
Moj nuse në shtatore ngrirë
Bardhësi buzëkuqe
Puthje në stinën e gabuar

Urim

(Kukësit n' trishtim, prill '99)

Mos u rritshin fëmijët pa prind
Mos na mbetshin kullat thatë
Mos mbete pushka pa një trim
Mos qaftë nëna fëmijët jetim
Kurrë më

THYERJE RRUGËSH

Ne dhe Evropa

Portretin tonë në pasqyrë
Shtrembër prezantuan
Galeritë e shurdhëta nder shekuj
Ngjyrë e ujë
Brushë e huaj
Piktor memec

Në pasqyrën e vjetër
Gjeni të vërtetën
Për ne
Për veten

Me shekuj gënjyer
Me pahir
Nga memecët e kohërave
Të shurdhëta
Të verbëta
Evropë e pikturuar me gjak

Çmenduri

Të pasionuar pas çmendurisë
Dikur dhe sot
Fusha e lojës
Figurat
Pasionet
Personazhet
Të njëjtë

Në kërkim të roleve tjetërfare
Lëvizin prapë
Në katrorët e Fushë Kosovës
Si në fushën e shahut
Bardhë e zi
Në lojën hileqare
Prapë
Të pasionuar
Për një mat të ri

Dëshmitarë

(Na ishte një herë)

Dëshmitarë të kohës ishim
Kur zagarë në pikë të ditës
Mu në jakën e xhaketës
Mbanin firmën e Titos...

Kolera kishte rënë atëherë në Kosovë
Ndërgjegje në peshojë para atdheut

Më thuaj
Sa hoqe nga kandari
A vdiq kush nga turpi
Më thuaj
Shpenzimet e varrimit
T'ia heq unë
Unë dëshmitari

O kohë e vrarë nga bryma e muzgut
Ndërgjegje e zënë nga myku
Ushqim i minjve të përhirtë
Sot pse jo
Të fshehur nën rrogozin e pavarësisë

Rrugët

Me gjak na u bë
Krahu dhe shpata
Në ndeshje me Bajlozët
Rrugë sakrifice
Liri e mbështjell në bajrak
Të sollëm
Me qerren e kuqe të nuses
Rrugëve të lara me gjak
Rrugë e gjatë
Rrugë
Gjak
Liri

Ajo...

Ah sikur të ishte gjallë burrëziu
Që ta vriste turpi më rëndë
Kusuret t'i lante në këtë botë

Jo
Më mirë
E hëngri vdekja me hak
Njollë e tradhtisë
Përgjithmonë
Larë me gjak

Vërtetë
Por gjurmë e gjakut të tij
Atdheut i mbeti të dera
Njollë e zezë
Përjetë
Ah e mjera

Para varreve të Dëshmorëve

Të nderuar pranë tyre
Me lule në duar
Në përvjetor
Në heshtje
Thjeshtë si vizitor
Madhështia atyre ju takon
Luteni ju atje
Para varreve heshtni

KËNGË LIRIKE

Asaj

Kohë e largët
Ndjenjë e vaktë
Herë e pashpjeguar
Herë e saktë

Kujtime të hershme rinore
Çastet të ëmbla përcjellë
Pa dashje
Ëndërr e mbështjellë
Si dhuratë
Më erdhe për shqetësim këtë natë
E lumi të marrtë

Atë

E shikoja me afsh
Nuk doja ta lëndoja
Në ëndrrat e saja të bardha
Me ndjenjat e mia të mallit të parë
Nuk lejojë
Ndjenjat nuk i fus në lojë
As një herë
Atë
Nuk dua ta lëndoi

Një ëndërr

Si gjithherë ëndrrat
Dhe në kohërat e pleqërisë
Mes kujtimeve
Të venitura të rinisë
Në derën e vjetër prej druri
Lehtas e me ndrojtje trokasin
Për lojën e lënë për gjysmë
Të thërrasin

O botë e ëndrrave kush s'të do
Për një çast ngacmimesh
Butësinë e ëndrrave
Në miklim
Që dorën zgjasin
Pranoni

KËNGË EPIKE

Fshatit tim

Kohë nostalgjike
A mund të të rikthej

Prekaz
Vendlindja ime
Të dua deri në amshim

Prekaz
S'kam tjetër shpjegim
Unë biri yt
Ti
Dinjiteti im

Fidanit

(Fidan Brestovcit 6 vjeçar që milicia serbe e vrau me 1995,
si dhe të gjithë fëmijëve të rënë gjatë luftës çlirimtare në Kosovë)

Ju vranë
Ata frikoheshin nga emri juaj
Fidan, ata deshën që pa ty
Pjesëtarë të UÇK-së të janë më pak
Por Fidanët e UÇK-së u rriten
U fisnikëruan
Morën armët
Për ju shumëfish
Morën hak

Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare

Prapë dikush do të vritet
Do të përgjaket dikush
Prapë dikush do të zgërdhiet
Do të përjargët dikush

Kambanat për mortin
Nuk do të pushojnë
Dikë do ta shajmë me breshëri
Dikë me breshëri do ta nderojmë
Rrugë të gjata janë këto

Kanë nisur e nuk sosen
Lirinë e atdheut kërkojnë

Dritanit

(Dritanit, bashkëfshatarit tim dhe
bashkëmoshatarëve të tij që ranë për liri)

I riu i heshturi i miri Dritan
Kurrë nuk u ankove
Nga jeta e mundimshme

Kur pushka e lirisë krisi
Ishe aty
I pari në radhët e UÇK-së
U bashkove me lumin e pavdekësisë
Dritan
I riu i heshturi i miri Dritan

Të vranë

(Avdi Mujës- luftëtarit të pa epur)

Tash po vjen o vëlla pranvera
Po të pret motra të dera...

S'të vranë dot pushtuesit
Ti i dije të gjitha shtigjet
Të vranë kusarët dhe hajdutët
Në pabesi dhe prapa shpinës
Dorë e tradhtisë të qëlloi
Duke i vu lirisë themelet
Kosova ende po lëngon
Nga njerëzit e zinj të territ

Pranverë e '81-shit

Këmishë e pranverës u përgjak
Plagë e vjetër në shtat
Flakë lirie e bartur nder shekuj
Bartur besnikërisht në gji
Pranverë e trëndafilave të kuq
Pranverë e motit të madh
Një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një
Stinët e rilindjes
Drejt shtigjeve të lirisë
Kosova gjakoi

Skënderbe

Rrugëtim nëpër shekuj
Nga Kruja në Prishtinë
Pesëqind vjet rrugëtim

Shqiptarët peshën e robërisë
E barten gjatë
Si guri mbi shpinë
Shumë gjatë
Nga Kruja në Prishtinë
Pesëqind vjet rrugëtim

Shkëlqimi në bronz

(Ismet Jasharit- Komandant Kumanovës)

Shkëlqimi yt në jetë
Shkëlqimi yt në bronz
Gërshetim madhështor
Shtatore në pedestal
Shkëlqim që vret
Lugetërit e mesnatës
Në ato anë
Që dje Prizrenin
Shkelnin me këmbë

Pushkës i besoj

(Ushtarëve të UÇK-së)

Kohës i bënë ballë
Nuk u gënjyen
Nga loja
As nga përralla në shkallë
Të vetëdijshëm se liria nuk vjen
Mbështjell si dhuratë
Ata besuan dhe u betuan
Në pushkën e gjatë
Për lirinë e atdheut
Me fat

Pushka

Krismë e saj
Mes tytës së vogël
Rrugë të mëdha hapi
Në çarkun e zjarrit
Dorën shtrinë zot e saj
Dhe zotët e tokës
Bijtë e Kosovës
Hallemadhe

Legjendarit Adem Jashari

Kur erdhe në këtë botë
Qetësinë theve me zërin tënd
Kur ike nga kjo botë
Frikën vrave

Me pushkën e gjatë

Flisje pak
Puna të fliste shumë

Ngadhënjeve mbi vdekjen
Lotin e ktheve në shpresë
Një brez i tërë
Nga kënga në Legjendë

Shkëmbinjtë

(Z.Pajazitit, E.Hoxhës, H.Zejnullahut)

Në përplasje me shtrëngatat
S'u luhatën
Ngritën gjokset dhe shpatullat
Përballë stuhive
Shkëmb i rëndë
Kohë në kacafytje
Rrudhat në ballë i shton
Lapidarë i gdhendur në gurë
Dëshmitar i kohës sonë

Jusuf Gërvallës

Secili deshi pjesë nga ju
Për ju nderuan
Trimat
Të ndershmit atdhetarë
Tani nga ju nder duan
Një rrëmujë e tërë
Hajnash e kusarë

Të vetëdijshëm se këto lojëra
As s'ju ulin as s'ju ngritin
Po të ishte gjallë Jusufi
Vallë
Do ta mohonte fisin

Në janarin e ftohtë
Do t'ju vizitojmë
Në janarin e ftohtë akull
Jusuf
Tri varre pranë e pranë
Në Kosovë
Ende presin hapur

LOTËT QË S'U THANË

Të zhdukurve të luftës

Pa ju
Oxhaku tymin e nxjerr si në lojë
Gjokut i ka rënë patkoi
Babai vdiq
Me tëndin përmallim
Nëna flokët s'i bënë më me bojë
Djali të është rritur e pyet
Babai pse s'vjen ku shkoi
Nusja mbanë kandilin në dorë
Kandili
Në vend të vajit lot pikoi

Bonjakët

Fëmijët e të rënëve për liri
Ju do të rriteni pa dyshim
Me pranverën e parë
Në ndërgjegjen e kombit
Jeni peshojë
Kandar

Njeriut të mirë

Këtë siluetë duhet ta ndiqni
Të ndiheni brenda sajë
Me këmbë në tokë
Njeriu i mirë
Një jetë të tërë
S'e bëri kënd me vajë

Shpërngulje e dhunshme

Si në kohërat biblike
Në mijëvjeçarin e egër
Me dhunë i nxorën
Shqiptarët nga shtëpitë
I nxorën me thikë
Serbët barbarë
I nxorën
Në rrugën e gjatë
Nënë gjethet e lisit
Mos harroni
I bënë refugjatë
Mos harroni

Varrezat masive

Ndër varrezat masive të shqiptarëve
Kërkojnë nënat bijtë e vet
Mijëra të vvarë e të masakruar
Varrosur në gropa

E nuk i dallon dot
Rrokur për qafe nusja me vjehrrën
Fëmija me gjyshin, motra me motrën
E nuk i dallon dot
O zot

Ngatërrohet një dorë
Një këmbë
Kjo kokë
Biri cilës nënë i takon
Koha ka tretur
Humbur gjurmë e nishan

Nënat tona të mbytura në lot
Cilin ta marrin
Cilin ta lënë
Dhe nuk e lënë dot
O zot

Si t'i ndajmë
Si t'i dallojmë
E si ndajmë dot

Mos i ndani
Të gjithë janë tanët
Janë tagri i shtrenjtë
Që shqiptarët e paguan
Për lirinë e vet

Janë dëshmia e sakrificës
O ju njerëz ju lutem
Kujdes
Historia mund të përsëritët

MALLI QË GËRRYEN

Mësuesit tim
(Sokol Mehës)

Na shpjegoje qetë e me keqardhje
Për këtë fundshekull të marrë
Na përgatisje
Për rrugë të gjata
Ka me ardhur koha na thoshe
Vërtetë
Koha erdhi profesor Sokoli
Ti nuk e prite
Vdekja tinëzare herët të mori
Më shumë se një kujtim
Për mësuesin tim

Kohë

Jeta nuk është vetëm kohë
Kohë që rrjedh si lumi
Ti pajtohesh me vdekjen
Dhe e kërkon atë në kohë
Unë e dua jetën
Dhe luftoj për te
Me ngulm
Në kohë

Malli

Diçka në gjoks po më djeg
Diçka po më gërryen
Si duhanxhiun e vjetër
Kur e mbështjell
Edhe dushkun me letër

Malli më ka zënë
Për nënëloken
Për aromën e lule shtogut
Për pragun e shtëpisë
Për vrapin e gjokut
Për lojërat e fëmijërisë

Kanë thënë
Malli
Gërryen gurin

Mërgimi

Nga qengj i butë
Të del ujk me dhëmbë
Të tretë të dërmon
Buzëqeshjen ta ndrydh malli
Tkurresh e nuk mbetesh
Sa një kokërr limoni

SHKËNDIAT NË HORIZONT

Ndjehuni

Kosova
Sot më shumë se kurrë
Pret
Në themel nga një gurë
Ç'prisni ndjehuni
Kalanë e përjetësisë ta bëjmë
E pastaj të rrojmë
Secili me punën e vet

Ndjehuni

Bashkohuni

Atdhedashës
Dijetarë
Luftëtarë
Të ndërgjegjshëm
Bashkohuni
Do shihni pastaj
Si për inat do bashkohen
Hajna lakej e kusar
Të ndyrë e hileqarë
E pastaj ju
Do të jeni të lirë

Të besosh

Jeta në lakuriqësinë
E besimit të verbër
Pa nuancat e veta ekstreme
Gjunjëzohet
Para pikturës pornografike zhgërryer
E pa zë thotë
Zoti vet
T'i besojmë krijesës së tij

Jeta

Ne rrugëtojmë në te
Pa pikë fillimi e mbarimi
Në lëvizje
Si në një stacion të largët harrimi
Dikujt ju kujtua
Jeta
Ah një lutje për mua
Ora e fundit thërret
Jeta
Ç'është kjo që e duam
Me çdo kusht
Edhe me kushtin e turpit

Babait

Fillim maji në agim
Na gënjeu
Në pikë ndarjen tonë
Një pikë loti
Shënoi një lojë të re
Mes jetës e vdekjes
Pengu i kujtimit lënë

Bartur nga ati ynë
Adam
Mbi vdekjen e parë
Koha na mësoi me ndarjet

Vallet

Mjeshtri arti nga lashtësitë
Përmes valles që fletë
Nder brezni bartur
Me shpatën e rëndë në dorë
I mundem armiqtë
Me këngë
I pritem miqtë

Strategji e vallëzimit
Të një epike
Në vazhdimësi
Valle

SHKOJNË DHE NUK KTHEHEN

Dua

(Dritëro Agollit)

Poezinë shfletova
Me kujdes
Atë takova
Me fanar ndezë

Vargun lozonjar
Se bashku me Dritëronë
Dhe poezinë e parë
Prapë takova Dritëronë
Në dorë me fanar

Fëmijëve të mi

(Lules dhe Arës)

Nuk e di a mundem
Vargun zap ta bëjë
Të shkruaj
Diçka nga të papriturat
Diçka me admirim
Për fëmijët
Edhe për fëmijët e mi
Me përkushtim
Nuk e di

Miku i vërtetë

Një Mik do ta takosh në jetë
Një
Një mik të vërtetë
Do ta gjesh
Në kthetrat e jetës
Nuk do të lë fillikat
Nuk do të lë vet
Një

Gjethet e vjeshtës

Shkujdesur nëpër rrugë
Paskeni rënë
Nga trangu shkëputur
Stinë që vret bukurinë në heshtje
Dhe ngjyrat tretë
Gjethet e stinës së verdhë
Shkujdesur mbi rrugë
Shkapërderdhë

Një kovë ujë

Kur dalim nga shtëpitë
Shtigjeve të malit
Pimë nga kova me ujë

Besëtytni a hyjni
Në mitizim
Dëshirë e nënës
Për kthimin e djalit
Para kovës me ujë
Dhe duarve të nënës
Përkulemi

Rrita

Mbahu

(Mejremit, motrës së Fadil Vatës)

Mbahu motër
Koha të goditi rëndë
Sprovë e jetës sonë
Në kërkim të lirisë
Motrës i ra hise
Shami e zisë

Pa dyshim
Lulëkuqet e para të prillit
Do i vemi

Mbi varr të Fadilit
Mbahu motër

Shqiponjës
(varg i huazuar)

Një varg dua ta vjedh
Për ty
Për të bukurin flamur
Kush para teje
Nuk u përkul

Sot shumë korba thonë jemi shqipe
Si i duron e kryet s'ua shtype

Rrita

Dalë e ngadalë u rritem
Për ditë e nga pak
Rrugët e pafund
I rimorëm
Amanetet e të parëve kujtoni
Kthim mbrapa
Mos lejoni

Shiu

Kur vapa është e prushtë
Bujku humb shpresën

Vjen shiu i prajshëm
Ia kthen buzëqeshjen
Shiu
Flori në maj
Argjend në gusht

Hënëz e kuqe

E vërteta

Kartat ranë
Trupi u zhvesh
Turpi mbeti lakuriq
Dikush turpin
Vetë do ta hajë
Dikush do ta hajë me miq
Me turp dikush rron gjithë jetën
Një ditë
Dikush

Do ta thotë të vërtetën

Pendimi

Kush rron po të vdesim ne
Ata vdiqën për këtë dhe
Ne për kë jetojmë
Po të bëhej një sondazh
Do pendohen
Ata më parë
Apo ne që frymojmë

Dy të marrë

U takuan dy të marrë
Si të marrë që ishin
Bënë shamatë në pazar
Në pazarin e Prishtinës
Pretendonin për kryetarë

Ngjarjen shënuan gazetatat
E bëjnë gjellë e sallatë
Sonte
Kryeqytetasit s' do ta hanë
Darkën thatë

Ma jepni shkopin

Më duhet të mbështetem diku
Pranë lartësive të bardha
Si zogut që fluturon mbi re
Larg e më larg nga përbaltja

Jam i vetëm tani
I vetëm fillikat
Natën duke e çarë
Me shkopin e gjatë
Mos më ankoni tani
Se nuk ua falë dot

Kam nevojë

Për ty kam nevojë toka më rëndon
Sizifi do të mi verbojë sytë
Që plotë dritë i kam
Ti
Popullin zhveshe
Nga ndjenjat e robërisë
Pinguinët po të shajnë
Larg

Mbi akullin e ngrirë
Për ta thënë të vërtetën
Kam nevojë
Pinguinëve le t'iu mbetet
E shara në gojë

Në heshtje

Tinëzisht e në heshtje
Theve gotën e kristaltë
Dhe me dashje i bërë
Njerëzit me baltë

Tinëzisht e në heshtje ike
Me bishtin nën shalë
Ike
Si dhelpra në mal
Në kurthet e lojës
Dikush ka për të rënë

Do ndahemi

Një ditë do të ndahemi
Prej këtij stili të rëndë
Stil i të jetuarit mbrapsht
Me lajka në gji
Moral i rënë për tokë
Qe shitesh e blihesh
Pa lekë e me lekë
Vallë
U shite edhe ti
Ndahemi

Lehjet

Një jetë të tërë qentë lehen
Nën strehët e shtëpisë
Lehnin në hënëzën e kuqe
Të yshtur prej smirëzisë

Hënëza perëndoi
Dhe ajo lindi prapë
Qentë lehnin pas lakmisë
Dhe ngarendin në vrap
Lehin qentë

Bythë e kuisë

Nuk ndenjen duarkryq intelektualët
Sfidë serioze i bënë Serbisë
Me mendimin filozofik aktual

Rrahën me shkop bythën e kuisisë

Bythë e kuisisë rënë nga ndryshku
Lënë në mezhde me një anë
Shpikje e një strategjie të re
Të artit luftarak në Ballkan

Rrethi i kuisisë po krekoset
Me bythën që boja po i del
Sikur të realizohej kjo filozofi
Do konkurronin çmimin Nobel

Në dukje

Duket njeri i mirë
Me pamje te qetë
Eh sikur brendi e shpirtit
Me dukjen të ngjet

Vërtetë
Në dukje u mashtrua
Dhe Eva me Adamin
E shtrinë këmbët më gjatë
Se ç'kishin jorganin

Përmbajtja e librit

THE MELE T E GUR T A

Kujdes
Mbi muret e Dubravës
Kullat

K Ë N G Ë N O S T A L G J I K E

Atdheut tim
Zjarri i vatrës sime
Djepi
Mos
Një ditë
Natë

B A L A D Ë P Ë R S H O K Ë T

Unë dhe ti
Po vjen pranvera
Kthehu
Ukshin Hotit
Një jetë të tërë
Bacë Rifatit

GJETHET E VERDHA

Plaku
Këpucës
A ka më keq
Bretkosat
Dikur
Dy mendësinë
Ngjyrë e verdhë

E BARDHA QË VRETË

Loti
Qëllimi
Dimri
Urim

THYRJE RRUGËSH

Ne dhe Evropa
Çmenduri
Dëshmitar
Rrugët
Ajo
Para varreve të Dëshmorëve

KËNGË LIRIKE

Asaj
Atë
Një ëndërr

KËNGË EPIKE

Fshatit tim
Fidanit
Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare
Dritanit
Të vranë
Pranverë e '81-shit
Skënderbe
Shkëlqimi në bronz
Pushkës i besoj
Pushka
Legjendarit Adem Jashari
Shkëmbinjtë
Jusuf Gërvallës

LOTET QË SU THANË

Të zhdukurve të luftës
Bonjakët
Njeriut të mirë
Shpërngulja e dhunshme
Varrezat masive

MALLI QË GËRRYEN

Mësuesit tim
Kohë
Malli
Mërgimi

SHKËNDIAT NË HORIZONT

Ndjehuni
Bashkohuni
Të besosh
Jeta
Babait
Vallet

SHKOJNË E NUK KTHEHEN

Dua
Fëmijëve të mi
Miku i vërtetë
Gjethet e vjeshtës
Një kovë ujë

R R I T A

Mbahu
Shqiponjës
Rrita
Shiu

HËNËZ E KUQE

E vërteta
Pendimi
Dy të marrë
Ma jepni shkopin
Kam nevojë
Në heshtje
Do ndahemi
Lehjet
Bythë e kuisë
Në dukje

